



alba - beton sh.p.k
prodhime betoni • tirana
concrete production • earthwork • tirana

V E N D I M

Nr. 5, Viti 2019

|

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË

SHOQËRISË “ALBA BETON” SHPK

Sot, më datë 26.09.2019, në Tiranë, në Selinë e Shoqërisë “Alba Beton” Shpk, të ndodhur në adresën: Fshati Stërmash, Komuna Petrelë, Tiranë, Shqipëri, zhvillohet mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të kësaj Shoqërie.

Shoqëria “Alba Beton” Sh.p.k. është regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me numër 15971, datë 27.07.1996, me NIPT J62207004A, me një kapital në shumën 952.696.000Lekë tërësisht i shlyer, me ortakë të shoqërisë Z.Adrian Dulaku, që zotëron 29.7% (njëzet e nëntë pikë shtatë përqind) të pjesëve në kapitalin e shoqërisë, Z.Genci Dulaku, që zotëron 29.7% (njëzet e nëntë pikë shtatë përqind) të pjesëve në kapitalin e shoqërisë, Z.Artan Dulaku që zotëron 30.6% (tridhjetë pikë gjashtë përqind) të pjesëve në kapitalin e shoqërisë dhe Z.Erjon Harizi që zotëron 10% (dhjetë përqind) të pjesëve në kapitalin e shoqërisë, që të katërt sëbashku përbëjnë 100%(njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Në këtë mbledhje të zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Alba Beton” Shpk, të thirrur me kërkesën e të gjithë ortakëve të shoqërisë, verifikohet pjesëmarrja e ortakëve të shoqërisë dhe rezulton që marrin pjesë dhe janë të pranishëm ortakët, si më poshtë:

1. **Z. Adrian DULAKU**, shtetas shqiptar, i biri i Nikos dhe i Lirikës, i datëlindjes 05 Shkurt 1960, në Tiranë, Shqipëri, banues në adresën: bulevardi “Bajram Curri”, godina ETC, katër i 17-të, Tiranë, Shqipëri;
2. **Z. Artan DULAKU**, shtetas shqiptar, i biri i Nikos dhe i Lirikës, i datëlindjes 30 Maj 1965, në Tiranë, Shqipëri, banues në adresën: rruga “Farke, Tiranë, Shqipëri;
3. **Z. Genci DULAKU**, shtetas shqiptar, i biri i Nikos dhe i Lirikës, i datëlindjes 19 Dhjetor 1967, në Tiranë, Shqipëri, banues në adresën: bulevardi “Bajram Curri”, godina ETC, katër i 17-të, Tiranë, Shqipëri;
4. **Z. Erjon Harizi**, shtetas shqiptar, atësia Refat dhe amësia Xhezare, i datëlindjes 19.10.1979, lindur në Lumas, Berat dhe banues në Tiranë, që do të thotë se janë të pranishëm 100%(njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë “ALBA BETON” Shpk, gjë që do të thotë se asambleja është thirrur rregullisht, në gjendje për të diskutuar dhe vendosur mbi,

Rendin e ditës si më poshtë:



alba - beton sh.p.k
prodhime betoni • tirana
concrete production • earthwork • tirana

1. Shqyrtimin e raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "ALBA BETON" Shpk, të hartuar nga studio "Filto Auditing" shpk, me Eksperte Kontabël të Autorizuar Zj. Tatiana Filto(Kotepano) me Nr.Licenze 67.
2. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "ALBA BETON" Shpk.
3. Të tjera dhe eventuale.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "Alba Beton" Shpk, shqyrtoi dokumentacionin dhe aktet përkatëse, në zbatim të nenit 96 e vijues të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në përfundim,

V E N D O S I :

1. Të miratojë "Raportin për zmadhim kapitali", të datës 24 Shtator 2019, të hartuar nga studio "Filto Auditing" shpk, me Eksperte Kontabël të Autorizuar Zj. Tatiana Filto (Kotepano) me Nr.Licenze 67, e cila ka evidentuar zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Alba Beton" Shpk.
2. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Alba Beton" shpk, nëpërmjet rezervave të krijuara nga fitimet e vitit ushtrimor 2015, 2017 dhe 2018, për vlerën prej 181'408'000 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e katërqind e tetë mijë) Lekë, shumë e cila do të kalojë përritjen e Kapitalit të Shoqërisë, duke bërë që të rritet kontributi i Ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë në përputhje me përqindjet e zotëruara në vlerat e mëposhtëme:
 - **Z. Adrian DULAKU 53'878'176 Lekë (Pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë lekë)**
 - **Z. Artan DULAKU 55'510'848 Lekë (Pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e dhjetë mijë e tetëqind e dyzetë e tetë lekë)**
 - **Z. Genci Dulaku 53'878'176 Lekë (Pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë lekë)**
 - **Z. Erjon Harizi 18'140'800 Lekë (Tetëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzetë mijë e tetëqind lekë)**
3. Si rrjedhim i këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë "Alba Beton" shpk, bëhet në vlerën totale prej, 1'134'104'000 (Një miliard e njëqind e tridhjetë e katër milion e njëqind e katër mijë) Lekë, duke bërë që kontributi i Ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë pas kësaj rritje të jetë si më poshtë.
 - **Z. Adrian DULAKU 336'828'888 Lekë (Treqind e tridhjetë e gjashtë milion e tetëqind e njëzetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë lekë) – 29.7%,**
 - **Z. Artan DULAKU 347'035'824 Lekë (Treqind e dyzetë e shtatë milion e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzetë e katër lekë) – 30.6%**



alba - beton sh.p.k
prodhime betoni • tirana
concrete production • earthwork • tirana

- Z.Genci Dulaku 336'828'888 Lekë (Treqind e tridhjetë e gjashtë milion e tetëqind e njëzetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë lekë) – 29.7%
 - Z. Erjon Harizi 113'410'400 Lekë (Njëqind e trembëdhjetë milion e katërqind e dhjetë mijë e katërqind lekë) – 10%
4. Pas përfundimit të temave të rendit të ditës, duke mos patur gjë tjetër për të diskutuar, shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera, të cilat mbeten ashtu siç janë. Drejtuesi shpall mbylljen e kësaj mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Alba Beton" shpk.
5. Sa më sipër, ky vendim së bashku me Raportin e Zmadhimit të Kapitalit, do të depozitohen për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe nenin 43 e vijues, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Asambleja e Përgjithshme

Shoqëria "ALBA BETON" Sh.p.k.

Ortakët e Shoqërisë

Z. Adrian Dulaku

Z.Artan Dulaku

Z.Genci Dulaku

Z.Erjon Harizi

